



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.19, datë 23.10.2019

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“NDËRTIMI I RESORTIT TURISTIK “PERLA”,  
NË KOMUNËN ISHËM, QARKU DURRËS

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Perla-S12” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i Resortit Turistik “Perla”, në Komunën Ishëm, Qarku Durrës, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.13, datë 10.05.2013, me subjekt zhvillues shoqërinë “Perla-S12” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 13, datë 10.05.2013 nuk ndryshon.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Bashkinë Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

**BLENDI KLOSI**



**SEKRETAR I KKT**

**LEDIA TOTA**

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

